

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

“SHËRBIME KUJDESI PËR KAFSHË”

Niveli III në KSHK¹, referuar nivelit III të KEK²

H9-III-18

Tiranë, 2018

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	Shërbime kujdesi për kafshë			Kodi
Kohëzgjatja	900-1100 orë	Niveli	III në KSHK, referuar nivelit III të KEK,	H9-III-18
Qëllimi:	Qëllimi i kualifikimit profesional “Shërbime kujdesi për kafshë”, niveli III-të, në KSHK, referuar nivelit III të KEK, është të përgatisë punonjës të kualifikuar, që lidhen drejtpërdrejt me fushën e mbarështimit dhe shërbimeve të kujdesit për kafshët, si dhe të zhvillojë personalitetin e individëve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon.			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	<p>Në institucionet e arsimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional “Shërbime kujdesi për kafshë”, niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kanë mbaruar dy vitet e para të arsimit profesional, të kualifikimit “Bujqësi”, niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK, - janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të kualifikimit profesional. 			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	<p>Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Shërbime kujdesi për kafshë”, niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe Supplementin përkatës të punonjësit të kualifikuar në këtë fushë.</p> <p>Ky arsimit profesional i jep individit mundësi t'i drejtohet tregut të punës si punëtor i kualifikuar në ferma të ndryshme blegtorale, njësi apo veprimtari të tjera që lidhen me mbarështimin dhe shërbimet e kujdesit ndaj kafshëve dhe shpendëve apo të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual ose familjar, në fushën e shërbimeve të kujdesit për kafshët.</p> <p>Më pas, individit ka të drejtë të vazhdojë kualifikimin, në nivelin IV të KSHK, referuar nivelit III të KEK, teknik/menaxher dhe fiton të drejtën e diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale” me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare</p>			
Data e validimit	(kur të miratohet)			
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	H-II-08-16			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

NJOHURI

Individi duhet të dijë të:

Parimet e etikës profesionale dhe organizimit të punës

- Të shpjegojë rregullat e veshjes dhe mirëmbajtjes së uniformës;
- Të përshkruajë parimet kryesore të etikës profesionale në punë;
- Të përshkruajë rregullat e higjienës personale;
- Të përshkruajë rregullat e higjienës mjeteve të punës, pajisjeve dhe vendit të punës;
- Të përshkruajë rregullat e përdorimit të mjeteve të punës;
- Të dallojë materialet e nevojshme për ushtrimin e përgjegjësive;
- Të përshkruajë rregullat e mbrojtjes në punë;
- Të përshkruajë rregullat e mbrojtjes së mjedisit;

Kujdesi dhe mirëqenia e kafshëve të fermës

- Të shpjegojë çfarë është kujdesi për kafshët dhe rëndësinë e saj;
- Të listojë pesë liritë, mbi bazën e të cilave vlerësohet mirëqenia e kafshëve në çdo sistem blegtoral;
- Të rendisë kërkesat minimale të mbrojtjes dhe mirëqenies për kafshët që mbarështohen në fermë;
- Të shpjegojë rëndësinë e shërbimeve në kafshë, në përshtatje me qëllimin e mbajtjes së tyre, në përputhje me nevojat e tyre fiziologjike dhe veçoritë e llojit;
- Të shpjegojë rëndësinë e qetësuesve, në ndërhyrjet kirurgjike ose manipulimet, të cilat u shkaktojnë dhimbje dhe vuajtje;
- Të listojë detyrimet e pronarëve dhe kujdestarëve të kafshëve, gjatë shërbimeve në fermë;
- Të shpjegojë rëndësinë e mbajtjes së regjistrit të trajtimeve mjekësore të kafshëve;
- Të listojë të dhënat për kafshët të regjistruara në regjistrin e trajtimeve mjekësore të kafshëve;
- Të identifikojë masat që duhen ndërmarrë për parandalimin e luftimeve ndërmjet kafshëve;
- Të listojë llojet e sjelljeve të kafshëve dhe shenjat kryesore në këto sjellje (sjellje seksuale, sjellje të ikjes, sjellja e mbrojtjes, sjellja shoqërore, sjellje në situata stresuese, ...);
- Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të gjendjes së përgjithshme shëndetësore të kafshëve;
- Të përshkruajë mënyrat e trajtimit të kafshëve për therje dhe rastet e therjes së detyruar;
- Të identifikojë mënyrat e transportit të kafshëve që garantojnë shëndetin, mirëqenien, duke shmangur dëmtimin\vuajtjet e panevojshme, në mjetet e transportit;
- Të listojë detyrimet e pronarëve të kafshëve të shoqërimit;

- Të shpjegojë rëndësinë e pasaportës mjekësore veterinarë për qentë dhe kafshët e tjera;
- Të shpjegojë rëndësinë mirëqenien e kafshëve të egra;

Personeli i shërbimit

- Të listojë kompetencat që duhet të ketë një personel shërbimi tek kafshët e fermës lidhur me shëndetin dhe mirëqenien e tyre.;
- Të listojë shenjat e kafshëve në një situatë jo normale lidhur me shëndetin gjatë inspektimit;
- Të listojë disa situata të rrezikshme për sëmundjet infektive të kafshëve;
- Të përshkruajë produktet e rrezikshme, mënyrën e trajtimit dhe përdorimin e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi gjatë ushtrimit të profesionit;

Akomodimi

- Të shpjegojë kushtet për hapësirat e strehimeve të kafshëve sipas llojit dhe kategorive të tyre, numrit të tyre në grupe, seksit, peshës, nevojave të sjelljes;
- Të përshkruajë kushtet e dyshemesë apo vendqëndrimeve lidhur me mirëqenien e kafshëve gjatë qëndrimit dhe lëvizjeve së tyre në vendstrehim;
- Të përshkruajë kushtet e rrugëkalimeve në një vendstrehim të kafshëve lidhur me mirëqenien e kafshëve (stresin, vuajtjet apo dëmtimet);
- Të shpjegojë kushtet e një vendqëndrim të kafshëve lidhur me hapësirat, pjerrësinë;
- Të analizojë arsyet e pjerrësisë së përcaktuar në vendqëndrimet e kafshëve;
- Të shpjegojë llojet e materialeve për ndërtimin e strehimeve në përgjithësi;
- Të shpjegojë llojet e materialeve për ndërtimin e vendqëndrimeve të kafshëve, të kafazeve, bokseve, pajisjeve, si dhe çdo vend tjetër që bien në kontakt me trupin e kafshëve;
- Të listojë cilësitë e materialeve për ndërtim lidhur me mirëqenien e kafshëve;(që mos të dëmtojë kafshët, të pastrohen dhe dezinfektohen lehtësisht);
- Të listojë faktorët në ndryshimin e mikroklimës të vendstrehimit;
- Të shpjegojë nivelet dhe korigjimet e faktorëve të mikroklimës në stallë për mos dëmtimin e kafshëve;
- Të listojë faktorët ndikues në ventilimin e strehimeve të kafshëve;
- Të shpjegojë domosdoshmërinë e ndriçimit natyral dhe artificial në kushte stalle;
- Të shpjegojë kushtet e mbarështimit të lirë të kafshëve në natyrë lidhur me mirëqenien e tyre;
- Të listojë teknikat për identifikimin dhe trajtimin e kafshëve për të kufizuar stresin;

Ushqimi, uji dhe substancat e tjera

- Të shpjegojë kushtet e një dietë ushqimore për energji dhe gjendje të mirë shëndetësore;
- Të listojë faktorët ndikues për një dietë ushqimore të përshtatshme për llojet e kafshëve dhe të shëndetshme;
- Të shpjegojë mënyrën e projektimit, ndërtimit të strehimit dhe vendosjes së pajisjeve të ushqimit dhe ujit për mos ndotjen e ushqimit dhe ujit në lidhje me mirëqenien e kafshëve;
- Të shpjegojë mënyrën e projektimit, ndërtimit të strehimit dhe vendosjes së pajisjeve të ushqimit dhe ujit për minimizimin e konkurrencës ndërmjet kafshëve për sisteme të ndryshme mbarështimi;

- Të shpjegojë metodën e futjes së një ushqimi të ri në dietën ditore;
- Të përshkruajë cilësitë dhe sasitë e ujit të pijshëm për furnizimin e kafshëve;
- Të përshkruajë plotësimin e nevojave ditore të ujit të kafshëve;
- Të përshkruajë mirëmbajtjen e sistemit të furnizimit me ujë dhe aksesin e kafshëve në njësinë e kohës për t'u furnizuar me ujë;
- Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të legjislacionit përkatës për shëndetin dhe higjienën e kafshëve;
- Të shpjegojë rëndësinë e leximit dhe kuptimit të etiketave të ushqimit;
- Të listojë teknikat e prodhimit të ushqimit për kafshët;
- Të shpjegojë rëndësinë e një diete të ekuilibruar sipas nevojave të kafshëve;

Riprodhimi, Shëndeti dhe profilaksia e kafshëve

- Të shpjegojë rëndësinë e kuptimit dhe identifikimit të fazave të ciklit riprodhues të kafshëve;
- Të përshkruajë mënyrat e riprodhimi për kafshë të ndryshme;
- Të shpjegojë veçoritë e një damazi i cili çiftëzohet me një kafshë femër përherë të parë në mënyrë që mos të shkaktojë vuajtje apo dëmtime gjatë lindjes;
- Të përshkruajë konceptin e profilaksisë kundër sëmundjeve infektive;
- Të shpjegojë llojet e profilaksisë për parandalimin e sëmundjeve të ndryshme në një fermë blegtorale;
- Të listojë masat që duhen pasur parasysh në profilaksinë e përgjithshme;
- Të argumentojë zgjedhjen e vendit për ndërtimin e stallave dhe materialet për ndërtimin e strehimeve të kafshëve bujqësore;
- Të identifikojë burimet e infeksionit të kafshët;
- Të shpjegojë dezinfektimin si një proces me rëndësi të madhe praktike;
- Të krahasojë llojet dhe metodat kryesore të dezinfektimit;
- Të analizojë karakteristikat e përgjithshme të lëndëve dezinfektuese;
- Të argumentojë faktorët e përcaktimit të shkallës së veprimit të dezinfektantëve;
- Të argumentojë masat për profilaksinë e veçantë;
- Të krahasojë karantinën me izolimin;
- Të shpjegojë masat e tjera parandaluese si: kushtet për kafshët e sëmura, personelin e duhur, asgjësimin e kufomave, grumbullimi e pastrimi i plehut etj.;
- Të listojë rekomandimet për kontrollin e kafshëve për të shmangur shpërthimet e sëmundjeve në tufë;
- Të listojë mënyrat e asgjësimit të kafshëve, materialeve dhe mbeturinave me djegie;
- Të shpjegojë rëndësinë e dezinfektantëve në ujë të pijshëm, në parandalimin e transmetimit të mikrobeve përmes ujit;
- Të shpjegojë rëndësinë e dezinfektimeve për kafshët dhe punonjësit në parandalimin e transmetimit të sëmundjeve;
- Të shpjegojë rëndësinë e masave veterinarë, për mbrojtjen e shëndetit publik nga sëmundjet zoonotike të përbashkëta për njerëz dhe kafshë;
- Të shpjegojë procedurën e marrjes së certifikatave shëndetësore, lejeve për eksport të kafshëve të gjalla dhe nënprodukteve të tyre (lëkura, leshi etj.);
- Të analizojë planifikimin dhe zbatimin e programeve vjetore të vaksinimeve, për luftimin e sëmundjeve të kafshëve, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të klasifikojë grupet e mëdha të substancave farmakologjike që përdoren gjatë trajtimit të një kafshe të sëmurë (antibiotikë, antiinflamator, analgjelzik, ...)

- Të shpjegojë rëndësinë e respektimit të kushteve të përdorimit të produkteve të përshkruara sipas udhëzimit të veterinerit;
- Të shpjegojë rëndësinë e vëzhgimit për efektet anësore të mundshme dhe transmetimi i tyre te veterineri;

SHPREHI PROFESIONALE

Individi duhet të jetë i aftë:

Parimet e etikës profesionale dhe organizimit të punës

- Të zbatojë rregullat e veshjes dhe mirëmbajtjes së uniformës;
- Të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe të higjienës së mjeteve të punës, pajisjeve dhe vendit të punës;
- Të përdorë pajisjet kryesore në vendin e punës;
- Të organizojë në mënyrë ergonomike vendin e punës;
- Të përzgjedhë mjetet e punës dhe materialet e nevojshme;
- Të pastrojë vendin e punës;
- Të zbatojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit gjatë punës;
- Të zbatojë procedurat e sigurisë në punë;
- Të zbatojë mënyrat e ndarjes së mbeturinave sipas llojit të tyre;
- Të zbatojë legjislacionin e punës në të gjithë elementët e tij;
- Të identifikojë situatat të rrezikshme gjatë ushtrimit të profesionit;
- Të identifikojë produktet e rrezikshme dhe t'i trajtojë ato në mënyrën e duhur në përputhje me legjislacionin në fuqi;

Kujdesi dhe mirëqenia e kafshëve

- Të zbatojë kërkesat minimale të mbrojtjes dhe mirëqenies së kafshëve për mbarështimin, prodhimin, përdorimin, shitjen, therjen, eliminimin dhe transportin sipas llojeve dhe kategorive të ndryshme të kafshëve;
- Të lejojë ndërhyrjet kirurgjikale\manipulimet, që shkaktojnë të kafshët dhimbje dhe vuajtje, vetëm me anestezi nga mjeku veteriner;
- Të mirëmbajë kafshët dhe të mos i braktisë ato;
- Të lejojë trajtim profilaktik veterinar të rregullt dhe ndërhyrje të menjëhershme mjekësore, në rastet e sëmundjeve apo dëmtimeve;
- Të zbatojë të gjitha masat për parandalimin e luftimeve ndërmjet kafshëve;
- Të identifikojë llojet e sjelljeve të kafshët dhe shenjat kryesore në këto sjellje (sjellje seksuale, sjellje të ikjes, sjellja e mbrojtjes, sjellja shoqërore, sjellje në situata stresuese, ...);
- Të kontrollojë gjendjen e përgjithshme shëndetësore të kafshëve, të paktën, një herë në ditë;
- Të lejojë kryerjen e një eutanazie nga mjeku veterinar sipas një plani masash veterinarë të miratuara;
- Të kryejë transportin e kafshëve me mjete transporti, në kushtet e mirëqenies së tyre;
- Të kryejë vizita për kafshët te mjeku veterinar me pasaportën mjekësore veterinarë, ku shënohen vaksinimet dhe trajtimet antiparazitare;
- Të sigurojë vaksinimin e detyrueshëm vjetor kundër tërbimit për qentë;

- T’u sigurojë kafshëve lëvizjen ditore gjatë mbarështimit në mjedisë të mbyllura;
- T’u sigurojë kafshëve një strehë dhe një zonë të lëvizjes së lirë, gjatë mbajtjes lidhur për një kohë të gjatë në mjedis të hapur;
- Të zbatojë detyrimin e vendosjes së maskës mbrojtëse në gojë qenve, gjatë nxjerrjes shëtitje;
- Të zbatojë masat higjienike gjatë ndotjes në vendet publike nga kafshët;
- Të zbatojë kërkesat minimale të mbrojtjes dhe mirëqenies së kafshëve të egra;
- Të zbatojë kushtet e mbarështimit të kafshëve të egra jashtë mjedisit të tyre natyror, vetëm në kopshte zoologjike, akuariume, terrariume, cirqe, ferma, voliera dhe vivariume;
- Të zbatojë kushtet e mbarështimit të kafshëve ekzotike në kushtet e shtëpisë, duke plotësuar kërkesat e mbrojtjes dhe të mirëqenies së kafshëve;

Akomodimi

- Të kryejë pastrimet e vendqëndrimeve të kafshëve dhe vendkalimet lidhur me mirëqenien e kafshëve;
- Të sigurojë dysheme të thatë, të pastër në vendpushimet e kafshëve, sipas llojeve të shtresës;
- T’u sigurojë hapësirën e duhur kafshëve në përputhje me nevojat fiziologjike dhe etologjike;
- Të vendosë kafshët në strehime në përputhje me llojin dhe kategoritë e tyre, numrit në grupe, seksit, peshës, nevojave të sjelljes;
- Të sigurojë ventilim të mjaftueshëm gjatë gjithë vitit në përputhje me llojin, peshën trupore, si dhe numrit të kafshëve;
- Të sigurojë në strehimet e kafshëve ndriçim të mjaftueshëm dhe ngarkesën e gazeve në limite;
- Të vendosë lidhjen midis sjelljes së një kafshe, mirëqenies së saj dhe faktorëve të ambientit;
- Të zbatojë teknikat e duhura për identifikimin dhe trajtimin e kafshëve për të kufizuar stresin;

Ushqimet dhe uji i pijshëm

- Të vlerësojë sasinë e foragjereve në dispozicion të kafshëve ;
- Të plotësojë nevojat e kafshëve me ushqime plotësuese në rastet e një ushqimi të pa mjaftueshëm;
- Të kontrollojë rregullisht peshën dhe llojin e ushqimit shtesë, nëpërmjet balancimit të nevojave të kafshëve;
- Të kontrollojë cilësinë e ushqimeve gjatë procesit të ushqyerit të kafshëve;
- Të zbatojë rregullat e mënyrës së dhënies së ushqimit gjatë ndryshimit të dietës ditore (futja e ushqimit të ri);
- Të kontrollojë të gjitha llojet e ushqimet qofshin dhe ato të lëngshme, si dhe kullotat për ndonjë ushqim apo substance të dëmshme;
- Të organizojë të ushqyerit e kafshëve për konsumim të barabartë ushqimi;
- Të organizojë furnizimin e kafshëve me ujë në sasi dhe cilësi, sipas nevojave në çdo orë të ditës ose sipas programeve të parapërgatitura;
- Të mbajë pastër koritat, pirëset automatike dhe rezervuarët e ujit;
- Të kontrollojë koritat, pirëset automatike dhe rezervuarët e ujit, të paktën një herë në ditë, për bllokime ose dëmtime;

- Të identifikojë dhe përdorë legjislacionin përkatës për shëndetin dhe higjienën e kafshëve;
- Të lexojë dhe kuptojë etiketat e ushqimit të kafshëve;
- Të zbatojë disa teknika të prodhimit të ushqimit për kafshët;
- Të llogaritë një dietë të ekuilibruar bazuar në produkte në dispozicion bazuar në informacioni e marrë sipas nevojave të kafshëve;

Pajisjet mekanike dhe automatike

- Të kontrollojë, të paktën një herë në ditë, pajisjet mekanike dhe automatike kryesore, si dhe funksionimin tyre;
- Të identifikojë defektet e mos funksionimit normal të pajisjeve;
- Të zgjidhë menjëherë problemet e defektit duke i riparuar, nëse mundet;
- Të përdorë metoda alternative në të ushqyerit dhe pirjen e uji;
- Të përdorë metoda të sigurimit dhe mirëmbajtjes së një mjedisi të kënaqshëm;

Riprodhimi

- Të identifikojë dhe kuptojë fazat e ciklit riprodhues të kafshët;
- Të përzgjedhë damazët e përshtatshëm për çiftëzim;
- Të inspektojë dy herë në ditë kafshët që janë afër pjelljes;
- Të monitorojë me kujdes estrusin në kafshë në mënyrë që mos të përdorin trajtime hormonale;

Shëndeti dhe profilaksia e kafshëve

- Të përzgjedhë vendin e përshtatshëm për ndërtimin e vendstrehimeve të kafshëve si dhe materialet për ndërtimin e tyre;
- Të kryejë veprime të thjeshta zooveterinare, për ruajtje e shëndetit të kafshëve;
- Të kryejë dezinfektimet e vazhdueshme dhe të detyruara të stallës e mjedisit;
- Të zbatojë masat për parandalimin e përhapjen e sëmundjes infektive;
- Të kryejë veçimin e kafshëve të sëmura, sipas porosisë së mjekut veterinar;
- Të ndryshojë kullotat për kafshët e sëmura;
- Të zbatojë planin e vaksinimit të kafshëve të shëndetshme;
- Të kryejë dezinfektimin e objekteve të kontaminuara nga kafshët e sëmura;
- Të kryejë dezinfektime në ujin e pijshëm për parandalimin e transmetimit të mikrobeve përmes ujit;
- Të sigurojë grupa dezinfektimi për këmbët, për kafshët dhe punonjësit.
- Të kontrollojë lëvizjen e kafshëve e shpendëve e nënprodukteve të tyre gjatë shfaqjes së sëmundjeve infektive e sidomos zoonozave;
- Të asgjësojë kafshët e ngordhura sipas rregullave;
- Të zbatojë me korrektësi rekomandimet e kushteve të përdorimit të substancave farmakologjike të përshkruara sipas udhëzimit të veterinerit;
- Të vëzhgojë te kafshët efektet anësore të mundshme dhe t'i transmetojë ato te veterineri;

KOMPETENCA TË PERGJITHSHME

Individi duhet të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efecientë.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt, procesin e të nxënimit të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij;
- Të demonstrojë sjellje dhe qëndrime etike në veprimtaritë shkollore dhe në komunitet;
- Të demonstrojë aftësinë për të pranuar dhe promovuar ndryshimin dhe inovacionin;
- Të demonstrojë aftësinë për të komunikuar dhe negociuar idetë në mënyrë eficiente me të tjerët;
- Të demonstrojë aftësinë për të menduar në mënyrë krijuese dhe novatore;
- Të demonstrojë aftësinë për të identifikuar dhe për të zgjidhur në mënyrë krijuese problemet.